

kufomën e Ibrahimit me vete. As sot e kësaj dite, familjarët nuk kanë njohuri për vendndodhjen e varrit të Ibrahimit. Rasti i tij është regjistruar në evidencën e të zhdukurve të KNKK-së me numër BLG-804227-01.

Burimet: deklarata A.C, FDH-851; deklarata M.S, FDH-32454; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex. 6D00614, FDH-35527.

Ramadan (Destan) Vuçiterna

(7.06.1932, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, shofer, tetë fëmijë)

Para fillimit të luftës, Ramadanit ka punuar si vozitës në BVI-në e arsimit në Rahovec/Orahovac. Jetonte në një shtëpi në lagjen përmbi Teqenë e Qytetit të Rahovecit/Orahovac, së bashku me bashkëshorten Hajrijen, djalin Fadilin me familjen e tij, si dhe bashkëshorten dhe fëmijët e djalit të dytë Faikut, i cili punonte në Gjermani. Të ditën e diel, rreth orës 15:00, djali i Fadilit, Fatoni, katërbëdhjetë vjeç, u plagos në këmbë nga një plumb çor. Ditën e diel, në mëngjes, më 20.07.1998, të gjithë familjarët, përpos Ramadanit, u nisën për në Malishevë/Mališevo, për të gjetur mjekun për Fatonin e plagosur. Po atë ditë, në orët e pasdites, Ramadanin para shtëpisë së tij e ka ekzekutuar me armë zjarri një polic serb, me të cilin Ramadanit paraprakisht hyri në polemikë [Rahovec/Orahovac]. Polemikën dhe të shtënat i ka dëgjuar komshiu i Ramadanit, Qaniu, i cili menjëherë pas largimit të policit i cili ka shtënë mbi Ramadanin, e ka çuar trupin e pajetë të Ramadanit në oborrin e Xhemajl Haxhijahes. Disa ditë më vonë, policia serbe e ka marrë dhe e ka çuar kufomën e Ramadanit në drejtim të panjohur. Pas shtatë vjetësh [28.05.2005], familjarët mësuan se ishin identifikuar mbejtjet mortore të Ramadanit, dhe se ato ishin zbuluar në varrezat e fshatit Hoçë të Madhe/Velika Hoča, në shtator të vitit 2003. Familjarët i kanë rivarrosur mbejtjet mortore të Ramadanit në varrezat muslimane në Rahovec/Orahovac më 2.06.2005.

Burimet: deklarata N.N, FDH-852; deklarata

N.N, FDH-855; deklarata Xh.B, FDH-863; deklarata N.N, FDH-866; deklarata N.N, FDH-879; deklarata N.V, FDH-880; deklarata F.V, FDH-32452; KMKRPF, *Personat...*, FDH-10832;

Ramadan (Halit) Krandalli

(11.11.1926, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, bujk, gjashtë fëmijë)

Ramadanit i moshëthyer ka jetuar vetëm në një shtëpi, në lagjen përmbi godinën e komunës së Rahovecit/Orahovac. Bashkëshortja i kishte ndërruar jetë para fillimit të luftës. Për të kujdeseshin dy vajza që ishin të martuara. Djemtë i kishte në mërgim. Kur forcat e UÇK-së hyrën në qytet, më 17.07.1998, te Ramadanit rastisi të ishte për vizitë nipi i tij Ardijani. Ramadanit i tha Ardijanit që menjëherë të shkonte në shtëpi, ndërkaq ai mbeti vetëm. Tri ditë më vonë, më 20.07.1998, komshiu i Ramadanit, Dula, e ka gjetur trupin e pajetë të Ramadanit në oborrin e plakut [Rahovec/Orahovac]. Kufoma e tij ishte e mbuluar pjesërisht me zall. Në shkallët e shtëpisë gjendeshin gjurmët e gjakut. Në mbrëmje, Dula i ka parë punëtorët e shërbimeve komunale, duke e marrë dhe çuar me traktor trupin e Ramadanit në drejtim të panjohur. Familjarët janë duke kërkuar ndriçimin e fatit të mbejtjeve mortore të Ramadanit edhe sot. Në listën e të zhdukurve të KNKK-së, rasti i Ramadanit është sistemuar në lëndën me numër BLG-804756-01.

Burimet: deklarata M.K, FDH-34336; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; 16 More Albanians Said to Have Been Slain by Serb Forces in Rahovec, pasqyra e lajmeve, KIC, 22.07.1998, FDH-29373; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.6D00614, FDH-35527.

Ismail (Ethem) Raba

(1938, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, rrobaqepës, pesë fëmijë)

Ismaili, i quajtur Malë, ka qenë rrobaqepës dhe tregtar. Ai me dy djemtë i kishin në pronësi tri shtëpitë, që e kishin oborrin e përbashkët. Pranë rrugës e kishin një butik. Ditën e premtë, në mbrëmje [17.07.1998],